

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Terapia për trajtimin e kancerit të prostatës mungon në Onkologji që nga maji
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/terapia-per-trajtimin-e-kancerit-te-prostates-mungon-ne-onkologji-qe-nga-maji
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:46:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 18:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cd59854b9fa633493499ca370ed022da9c7b5026e438e9c6adcbc7d8d9392fd9
TEKSTI	82cf11943fe275c5fe6545a088f6943cf2b10bdb4d040715bb77bd7929531cd0
PAMJA	2b0b47ed9b643a8171657eafda5d60d2751229703341a4f64d5c18eef9a14c59

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	508493c52cf5dc3433077398e8cd458fdc81701c961d13d41315e188a13e420a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/508493c52cf5dc3433077398e8cd458fdc81701c961d13d41315e188a13e420a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Terapia për trajtimin e kancerit të prostatës mungon në Onkologji që nga maji



Foto: Driton Paçarada

Nga: Arianita Hoti

12 shtator 2026 20:30

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Pacientët me kancer të prostatës po detyrohen ta blejnë vetë një nga terapitë që u nevojitet për trajtim. Edhe terapia Bikaderi, që prej muajit maj mungon në Klinikën e Onkologjisë. Mungesën disamujshje të kësaj terapie, njohës të shëndetësisë e lidhin me planifikimin dhe vonesat në procedurat e prokurimit.

Bikaderi është terapi hormonale që përdoret në trajtimin e kancerit të prostatës. Por kjo terapi ka muaj që mungon në Klinikën e Onkologjisë.

Pacientët që përballen me këtë sëmundje, tashmë detyrohen që edhe këtë ilaç ta sigurojnë vetë.

Një familjar i një pacienti i ka thënë KOHËS se terapia mungon në Klinikën e Onkologjisë që nga muaji maj.

“Shuma për me e siguru nuk është edhe aq e madhe, po përderisa ka pas në klinikë e tash nuk ka, është bërë e tepërt. Prej majit mungon, çmimi prej barnatore në barnatore dallon, diku 70 euro e diku 80 çdo muaj po kushton”, ka thënë një familjar i një pacienti.

E mos-hapja me kohë e tenderëve, sipas njohësit të shëndetësisë, Vlorjan Molliqaj, tregon se problemet me furnizimin nuk janë thjesht të rastësishme, por lidhen me mangësi në planifikimin dhe menaxhimin e barnave.

Edhe



Arbëri • 5 sht. 2026

Pacientët kërkojnë kompensim për barnat esenciale që i blenë vetë

“Kur tenderët hapen me vonesë, apo dështojnë për shkak se buxheti i planifikuar nuk përputhet me çmimet reale të tregut, kjo

Futboll.

Fitore e Rrahmanit me Napolin

Futboll.

“Fundi” jo i lavdishëm i karrierës së suksesshme të Rrahmanit te Kosova

Arbëri.

Ali Aliu në PIKË me Veton Surroin (II)

Futboll.

Mbyllet pa gola pjesa e parë e derbit gjilanas

Futboll.

Premier League sqaron pse goli i Haalandit ishte i rregullt

Futboll.

Prishtina dyfishon shifrat

regon qarte se nevojat nuk jane parashikuar dhe proceset nuk jane nisur me kohë. Në Onkologji, çdo vonesë apo ndërprerje e terapisë mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta në efektivitetin e trajtimit dhe, në raste të caktuara, edhe në ecurinë e sëmundjes. Prandaj, mungesa e barnave për pacientët me kancer nuk mund të trajtohet si një çështje e zakonshme administrative apo procedurale”, ka thënë Molliqaj.

Sipas Molliqajt, SHSKUK-ja duhet të planifikojë më herët dhe më saktë procedurat e prokurimit, në mënyrë që dështimet e tilla të mos përsëriten.

“Nevojitet një planifikim shumë më i saktë i nevojave, nisje më e hershme e procedurave të prokurimit, mekanizma të përsheptuar për sigurimin e barnave jetike dhe krijimi i një rezerve shtetërore që garanton furnizim për disa muaj. Është e papranueshme që pasojat e dështimeve në sistemin publik t’u barten pacientëve dhe familjeve të tyre, duke i detyruar ata që terapinë e domosdoshme ta blejnë me mjetet e veta. Përgjegjësia për sigurimin e vazhdimësisë së trajtimit duhet të jetë e sistemit, jo e pacientit”, ka vlerësuar Molliqaj.

KOHA i ka dërguar pyetje Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës lidhur me procedurat e prokurimit për këtë terapi, si dhe se kur pritet të furnizohet Klinika e Onkologjisë me Bikader, por deri në publikimin e këtij raporti nuk ka marrë përgjigje.

Edhe



Arbëri • 23 gus 2026

Avastini i shtohet listës së ilaçeve që mungojnë në Onkologji

KOHA ka raportuar vazhdimisht gjatë muajve të fundit për mungesat e barnave në Klinikën e Onkologjisë dhe vonesat në procedurat e prokurimit për shumicën e terapive që kanë munguar në këtë klinikë.

Në Onkologji, pacientët janë përballur edhe me mungesa të terapive, blerja e të cilave nga ana e tyre ka kushtuar deri në 5 mijë euro.

#KLINIKA E ONKOLOGJISË

#TERAPIA

#KANCER

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 17 gus 2026

Dabrafenibi mungon në Onkologji, jashtë Kosovës terapia kushton deri në 1.600 euro



Arbëri • 16 gus 2026

Pacientëve me kancer u duhet vetë ta blejnë medikamentin Bleomicinë



Arbëri • 12 gus 2026

Onkologjia që katër muaj pa terapinë Palbociclib

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale

Marketing

Politika e privatisësisë

Kushtet e përdorimit

sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhordh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.